

---

**REFERATE E KUMTESA**

---

**MARENGLLEN VERLI****50-VJET REVISTË  
“STUDIME HISTORIKE”  
(1964-2014)\***

Revista “Studime historike” është një revistë shkencore e sferës së albanologjisë, organ i Institutit të Historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike, e profilizuar në botimin e studimeve të shkurtra, apo artikujve, që lidhen kryesisht me historinë e popullit shqiptar nga antikiteti e mesjeta, deri në ditët tona. Përveç studimeve për tema të ndryshme të historisë, revista publikon edhe kumtesa të mbajtura në veprimtari të ndryshme shkencore (konferenca, simpoziume etj.), gjithashtu, dokumente arkivore me rëndësi të veçantë, pjesë memoarësh e materiale të zgjedhura të natyrës historike, mandej informacion për veprimtaritë shkencore, që organizohen nga Instituti i Historisë, ose ku marrin pjesë studiuesit e këtij instituti, etj. Periodikisht, jepet informacion edhe për botimet e Institutit të Historisë, për personalitete të fushës, kryesisht për shqiptarë, por edhe për albanologë të huaj etj.

Revista “Studime historike” është pasardhëse e revistës “Buletin i Institutit të Studimeve”, që publikohej në vitin 1947, mandej e revistës “Buletin i Institutit të Shkencave” (1948-1952), më tej e revistës “Buletin për shkencat shoqërore” (1952-1957), dhe, së fundi, e revistës “Buletin i Universitetit të Tiranës – seria shkencat shoqërore” (1957-1964).

Pararendësi i parë i revistës “Studime historike”, “Buletini i Institutit të Studimeve” ishte revista e parë shkencore në Shqipëri. Ajo u publikua nga Instituti i Studimeve, që u krijua në vitin 1946 si institucioni i parë i lartë kërkimor shkencor në Shqipërinë e Pasluftës së Dytë Botërore. Në kuadër të tij u krijua një seksion për gjuhësinë, letërsinë dhe historinë. Me këtë emër revista doli vetëm në një numër dhe më tej vijoi si “Buletin i Institutit të Shkencave”, që ishte organ i Institutit të Shkencave (1948-1957), vazhduesit të Institutit të Studimeve. Në Institutin e Shkencave figuronin përsëri seksione për gjuhësinë, letërsinë dhe historinë. Në vitin 1952 Buletini i Institutit të Shkencave u nda në Buletin për Shkencat

---

\* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Ditët e Albanologjisë Shqiptare”, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, dhjetor 2014.

Natyrore dhe Buletin për Shkencat Shoqërore. Ky i fundit trajtoi probleme të gjuhësisë, të historisë, të arkeologjisë, të etnografisë etj. (artikujt shoqëroheshin me përmbledhje në gjuhën frënge).

Në vitin 1955 seksionet e shkencave shoqërore u shkrinë duke formuar *Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë*, që në vitet 1957-1972 u inkuadrua në Universitetin e Tiranës. Në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë në vitet 1955 deri në vitin 1972 u bashkuan seksionet e gjuhësisë e letërsisë dhe të historisë, sociologjisë e ekonomisë, që kishin vepruar në kuadër të Institutit të Shkencave. Gjatë periudhës 1957-1964 studiuesit e Institutit botonin në revistën “Buletin i Universitetit të Tiranës – seria shkencat shoqërore”. Kurse që nga viti 1964, pra 50 vjet më parë, Instituti filloi botimin e dy organeve shkencore periodike të veta, pikërisht të revistës “Studime historike” (4 numra në vit) dhe të revistës “Studime filologjike”.

Krijimi i Akademisë së Shkencave në vitin 1972, solli një riorganizim të institucioneve shkencore. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, u nda në dy institute, përkatësisht në Institutin e Historisë dhe në Institutin e Gjuhës e të Letërsisë, të cilët ishin ndër institucionet kryesore të albanologjisë që u inkuadruan në Akademinë e Shkencave. Duke filluar nga viti 1973 revista “Studime historike”, tashmë pronë e Institutit të Historisë, vijoi të botohej me 4 numra në vit. Në vitin 1979 në Institutin e Historisë numri i sektorëve u rrit nga 5 në 7 sektorë. Krahas sektorëve të mëparshëm të historisë *mesjetare*, të *Rilindjes*, të *Pavarësisë*, të *Luftës Nacionalçlirimtare* dhe të *socializmit* u krijuan rishtas sektori i historisë *etnike* dhe ai i historisë së *Kosovës*. Veprimtaria shkencore e këtyre sektorëve, ku inkuadroheshin rreth 35 studiues, publikohej rregullisht në revistën “Studime historike”. Artikujt shoqëroheshin me një përmbledhje të shkurtër në gjuhën frënge, e cila më vonë, në vitet 90, u zëvendësua me gjuhën angleze.

Pas vitit 1991 numri i studiuesve dhe personelit ndihmës në Institutin e Historisë në rrethanat e tranzicionit, shkoi duke u reduktuar ndjeshëm. Pas reformës së vitit 2008, kur Instituti i Historisë u shkëput nga Akademia e Shkencave dhe u inkuadrua në Qendrën e Studimeve Albanologjike, të krijuar rishtaz, mbetën vetëm 16 studiues të organizuar në 3 departamente (ai i Mesjetës dhe Rilindjes Kombëtare, ai i Pavarësisë dhe ai i Historisë Bashkëkohore si edhe disa forca ndihmëse, që shërbejnë kryesisht në bibliotekën e Albanologjisë dhe në Arkivin e Institutit, të cilat duhet theksuar, se kanë qenë e janë shumë të pasura e

unikale dhe, fatmirësisht, janë ruajtur me fanatizëm. Në këto rrethana të reja revista “Studime historike”, pas një ndërprerjeje dyvjeçare (nr. 3-4 /1991 u botua në vitin 1994), rifilloi të botohet një herë në vit (në vitet 1994-1997 u botuan nga një numër në vit për vitet 1992, 1993, 1994, 1995, 1996 dhe 1997), për të vijuar më tej me dy numra në vit, me rreth 250-300 faqe në çdo numër. Aktualisht synohet jo vetëm forcimi i karakterit të mirëfilltë historik të revistës por edhe shtimi në revistë i artikujve nga studiuesit e Institutit, gjithashtu, rritja e rubrikave, afrimi gjithnjë e më shumë i bashkëpunëtorëve të jashtëm cilësor dhe së fundi, gjithashtu, duke siguruar institucionalisht mbështetjen e nevojshme financiare, për t’iu rikthyer publikimit të 3-4 numrave në vit.

Gjatë viteve të ekzistencës, duke marrë pikënisje vitin 1964, revista “Studime historike”, ka parë dritën e botimit 151 herë, duke publikuar rreth 38 000 faqe të veprimtarisë studimore e dokumentare nga historia jonë kombëtare.

Sipas një rregulli që vendoste drejtorin e Institutit të Historisë në pozicionin e kryeredaktorit, apo personit përgjegjës për revistën, nëpër vite atë e kanë drejtuar Stefanaq Pollo (1964-1991), Kasem Biçoku (1994-1996), Ana Lalaj (1997-2005), Marenglen Verli (2005-2007), Beqir Meta (2008-2014). Kurse në redaksinë e saj, gjatë 50 vjetëve të ekzistencës së revistës, kanë bërë pjesë Aleks Buda (zv.kryeredaktor), Deko Rusi, Gani Strazimiri, Luan Omari, Mentar Belegu, Petro Lalaj, Rrok Zojzi, Selim Islami, Zija Xholi, Muin Çami (zv. kryeredaktor), Hasan Ceka, Ndreçi Plasari, Viron Koka, Vladimir Misja, Aleksandër Meksi, Kiristaq Prifti (zv. kryeredaktor), Arben Puto, Besim Bardhoshi, Dervish Gjiriti, Koço Bozhori, Dhorka Dharmo, Myzafer Korkuti, Shyqyri Ballvora, Selami Pulaha (zv. kryeredaktor), Stavri Naçi, Iliaz Fishta (zv. kryeredaktor), Gazmend Shpuza, Veniamin Toçi, Xhemil Frashëri, Xhelal Gjeçovi, Luan Malltezi, Lefter Nasi, Dilaver Sadikaj, Hysni Myzyri (zv. kryeredaktor), Ferit Duka, Pëllumb Xhufi, Demir Dyrmishi, Fatmira Musaj, Hamit Kaba, Enriketa Kambo, Muharrem Dezhgiu, Dritan Egro, Ledia Dushku, Sonila Boçi, Edmond Malaj etj.

Në këto 50 vjet të ekzistencës revista “Studime historike” ka pasur bashkëpunimin e personaliteteve të spikatur të historiografisë shqiptare. Përveç anëtarëve të redaksive, njëherësh kontributore të revistës me produktin e vet shkencor, aty qëndrojnë firmat e Kristo Frashërit, Zija Shkodrës, Theofan Popës, Petraq Pepos, Ligor Miles, Paskal Milos, Petrika Thëngjillit, Ahmet Kondos, Franklin Xegës, Hëna Spahiut,

Dhimosten Budinës, Kolë Lukës, Frano Prendit, Bep Jubanit, Zhaneta Andreas, Apostol Kotanit, Iljaz Gogajt, Thoma Murzakut, Filip Liços, Vehxhi Buharasë, Zef Valentinit, Mikel Prenushit, Hysni Dajës, Piro Thomos, Mediha Shuteriqit, Dhimitër Andonit, Petro Shapos, Stilian Adhamit, Qamil Hasanit, Aleksandra Manos, Osman Myderizit, Aleko Harxhit, Drita Mehmetit, Skënder Anamalit, Spiro Shkurtit, Abaz Dojaka, Zef Prelës, Faik Lamës, Burhan Çirakut, Kaliopi Naskës (Karabecit), Aleks Luarasit, Shaban Çollakut, Pranvera Bogdanit (Novit), Përparime Hutës (Mengës), Nezir Batës, Zihni Haskajt, Mark Tirtës, Hysen Kordhës, Fatmira Ramës, Valentina Dukës (Kolçes), Zamir Shtyllës, Jani Sotës, Sokol Gjermanit, Ksenofon Krisafit, Pranvera Dibrës, Faik Qytykut, Liri Shimanit, Ariste Janos, Turhan Shilegut, Xhevat Repishtit, Zana Litos, Aurela Anastasit, Ilir Ushtelencës, Luan Zekës, Nestor Nepravishtës, Pal Doçit, Dhimitër Dishnicës, Nelson Çabejt, Vangjel Kasapit, Qazim Xhelilit, Ilira Çaushtit, Shyqyri Hysit, Kujtim Nuros, Irakli Koçollarit, Bajram Xhafës, Marenglen Kasmit, Hajredin Isufit, Adem Bungurit, Teodor Karecos, Sami Repishtit, Klara Kodrës etj. etj.

Në këtë kuadër do të duheshin përmendur edhe studiuesit shqiptarë ose me origjinë shqiptare, jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë qenë të pranishëm në faqet e revistës që nga viti 1981 e veçanërisht në 20 vitet e fundit, si Ali Hadri, Rexhep Qosja, Gazmend Zajmi, Sabit Uka, Aleksandër Stipçeviq, Thoma Kaçorri, Gelcu Maksutoviç, Françesko Altimari, Nexhip Alpan, Pajazit Nushi, Fehmi Agani, Ymer Jaka, Emin Pllana, Masar Kodra, Hakif Bajrami, Muhamet Shatri, Ramiz Abdylit, Izber Hoti, Jusuf Bajraktari, Selim Daci, Zef Mirdita, Syrja Popovci, Emine Bakalli, Fehmi Rexhepi, Iliaz Rexha, Haki Kasumi, Musa Limani, Hysen Ibra, Skënder Rizaj, Flamur Hadri, Shkëlzen Raça, Sabile Basha (Keçmezi), Jusuf Osmani, Jahja Drançolli, Fehmi Pushkolli Fehari Ramadani, Muzafer Bislimi, Memli Krasniqi, Muhamet Mala, Frashër Demaj, Sabit Sylja etj.

Nuk kanë munguar të prezantohen në revistën “Studime historike”, studiues të huaj si Alen Dyselje, Viktori Puzanova, Rusi Stojkov, Jens Reuter, Michail Schmid-Neke, Josef Macurek, Karl Göllner, Daniel György, Jashar Jyxhel, Hiqmet Syzer, Feyziogllu, Georgia Kretsi, Katerina Todoroska, Selda Kiliç, Orhan Kologllu etj.

Gjatë 50 viteve të botimit të revistës “Studime historike” artikujt e publikuar nga autorët e sipërpërmendur dhe më gjerë, kanë bërë objekt

aspekte të rëndësishme për historiografinë shqiptare. Këto janë lidhur me momentet më kulmore të historisë së popullit shqiptar, për të zgjeruar me kohë këndvështrimin në rrafshin kohor kronologjik dhe tematik. Në këtë kuadër vëmendje e veçantë i është kushtuar periudhës dhe problemeve të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, gjithashtu të Shpalljes së Pavarësisë dhe konsolidimit e demokratizimit të shtetit shqiptar, të rezistencës antifashiste në vitet e Luftës së Dytë Botërore, të rezistencës antiosmane në shek. XV, veçanërisht viteve kur ajo u zhvillua nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, etj.

Gjithsesi, kërkimi shkencor dhe artikujt e botuar në revistën “Studime historike”, fillimisht, jo në pak raste, pësuan deformime tematike dhe përmbajtësore, për shkak të skemave ideologjike dhe censurës të imponuara nga PPSH, përmes aparatit të saj. Parimet marksiste mbi rolin negativ të fesë, mbi luftën e klasave, mbi rolin e masave etj., diktonin në punën e historianëve jo vetëm në shtjellimin e interpretimin e ngjarjeve por edhe deri në përzgjedhjen e dokumenteve.

Censura partiake rëndonte veçanërisht mbi temat që trajtonin historinë e shek.XX, posaçërisht ato të Luftës e Pasluftës së Dytë Botërore, ku nuk mund të devijohet nga gjykimet e shfaqura nga E.Hoxha. Pavarësisht nga pengesat e sipërpërmendura, në faqet e Revistës u botuan studime që përbënin një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor për historiografinë shqiptare. Të rëndësishme ishin arritjet në publikimet e arkeologëve dhe studiuesve të prehistorisë, të cilët për disa vjet ishin të inkuadruar në Institutin e Historisë dhe i botonin arritjet e tyre në revistën “Studime historike”. Falë këtyre studimeve u ngrit në një nivel të ri dhe u ndriçua dukshëm historia e Ilirëve, që nga etnogjeneza e tyre deri në pragun e Mesjetës së Hershme.

Gjithashtu, në artikujt e botuar në revistë u hodh dritë mbi historinë e Mesjetës së Hershme në trevat arbërore, duke argumentuar praninë e shqiptarëve të hershëm në trevat e sotme të tyre, çka rrëzoi pikëpamjet e shfaqura për të kundërtën në historiografinë e huaj. Në artikujt të ndryshëm u trajtuan historia e formacioneve politike mesjetare të shqiptarëve, përkatësisht historia e Principatës së Arbërisë, u argumentua shqiptarësia e Principatës së Balshajve dhe veçanërisht u ndriçua formimi i shtetit të parë të pavarur kombëtar shqiptar të Skënderbeut.

Studiuesit e Institutit të Historisë dhanë në faqet e revistës vizionin e ri për periudhën e errët gati treshekullore, nga shek.XV në shek.XVIII, në trajtimin e temave shumëdimensionale me informacion të natyrës

politike, ekonomike, shoqërore e kulturore. U ngritën në një nivel tjetër edhe të dhënat për pashallëqet e mëdha shqiptare të fundshekullit të XVIII dhe fillimshekullit XIX, si dhe u publikuan studime të vyera që pasqyronin fillimet, karakterin, dinamikën dhe përmasat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Në saje të këtyre studimeve Rilindja jonë u dëshmuua se ishte jo vetëm një lëvizje letrare, por një lëvizje kombëtare çlirimtare, demokratike dhe iluministe, sikurse simotrat esaj në popujt e tjerë të Ballkanit, që synonte krijimin e shtetit kombëtar.

Studimet mbi historinë e Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë, ishin veçanërisht të shumta në faqet e Revistës dhe me tematikë të larmishme. Në to ka mjaft publikime me vlerë, që trajtojnë probleme rreth shpalljes së Pavarësisë (1912), rreth çështjes shqiptare në Konferencën e Londrës (1913), për zhvillimet politike dhe ushtarake në Shqipëri në vitet e Luftës së parë Botërore (1914-1918), për qeverisjen e princ Vidit (1914), për qëndrimet rreth çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes së Parisit (1919-1920), për zhvillimet në Kongreset e Durrësit dhe të Lushnjës (1920), për luftën çlirimtare të Vlorës (1920), për konfrontimet politike në vend periudha 1921-1924 dhe për Republikën e viteve 1925-1928 dhe Mbretërinë e viteve 1928-1939, për aspekte të jetës ekonomiko-shoqërore, për politikën e jashtme të Shqipërisë midis dy Luftërave Botërore etj.

Politizimin e ndjenë më shumë studimet me tematikë nga Lufta e Dytë Botërore dhe nga periudha e ashtuquajtur e socializmit. Në to konstatohet glorifikimi i kultit të Enver Hoxhës dhe PKS/PPSh, denigrimi i kundërshtarëve, mbivlerësimi i rolit të PKS/PPSh gjatë Luftës ANÇL, si dhe vlerësimi maksimal për veprimtarinë politike, ekonomike, sociale, arsimore etj., të regjimit që sundoi përrreth 45 vjet në Shqipëri në periudhën 1945-1991.

Në vitet '80, në rrethimin "Studime historike" filluan të botohen edhe artikuj të studiuesve të Institutit të Historisë për historinë e Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare, pas shkëputjes së tyre nga shteti kombëtar me vendimet e Konferencës së Londrës në vitin 1913. Gradualisht u promovuan gjithashtu studiues shqiptarë nga Kosova e Maqedonia. Veçanërisht në 24 vjetët e fundit numri i autorëve dhe larmia e temave për rreth 100 vjet të historisë së viseve shqiptare jashtë Shqipërisë dhe për diasporën është shtuar ndjeshëm. Gjithashtu nuk janë më tabu edhe temat për minoritetet. Në këtë mënyrë, në një shtrirje gjeografike që bën objekt studimi gjithë universin shqiptar të shek.XX, janë botuar në revistë

probleme rreth situatës së shqiptarëve në Kosovë, Çamëri e më gjerë, rreth politikës së ndjekur ndaj tyre nga qarqet drejtuese të Serbisë, Malit të Zi, Greqisë, Mbretërisë Jugosllave dhe Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, madje rreth organizatave, qëndresës dhe personaliteteve shqiptare në trevat e sipërpërmendura etj. etj.

Në vitet 90-të e në vazhdim, me vendosjen e pluralizmit politik në Shqipëri, me shpërbërjen e RFSJ dhe pavarësimin e Kosovës, si edhe me fitimin e një statusi të ri nga shqiptarët në Maqedoni e në Malin e Zi, në revistën “Studime historike” po botohen studime ku autorët parashtrojnë lirisht pikëpamjet e tezat e veta. Me këtë rast janë bërë hapa të rëndësishëm për trajtimin sa më objektiv e shkencor të shumë temave. Me konceptim të ri e me një bazë burimore bibliografike e dokumentar të shtuar, autorët kanë begatuar vitet e fundit revistën me prurje sasiore, aq edhe cilësore. Ajo është treguar mjaft aktive edhe në publikimin e kumtesave të një varg veprimtarish shkencore të rëndësishme si Konferenca shkencore kushtuar 80-vjetorit të Pavarësisë (Tiranë, 1992), Konferenca shkencore kushtuar çështjes së Kosovës (Tiranë, 1993), Konferenca kushtuar 2000 vjetorit të Krishtërimit në Shqipëri (Tiranë, 1999), Konferencat kushtuar 125-vjetorit dhe 130-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Prishtinë, Tiranë, 2003, 2008), Konferenca kushtuar 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut (Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2005), Konferencat shkencore kushtuar 95 dhe 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë (Tiranë, Prishtinë, Shkup, 2007, 2012), Konferenca për Mbretërinë Shqiptare (Tiranë, 2008), Konferenca kushtuar 100-vjetorit të Principatës Shqiptare (Durrës 2014), Konferencës kushtuar 100-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore (Prishtinë), Konferencave kushtuar ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore dhe Lëvizjes Antifashiste (1999, 2013, 2014, Tiranë, Prishtinë), Konferencave kushtuar Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (Shkodër, 2003) etj. etj.

Në këtë 50-vjetor të jetës së saj revista “Studime historike” dhe brezat e studiuesve që kontribuan për të, kanë të drejtë të krenohen për një bilanc shumë pozitiv, të arritur në vite me shumë mund e pasion, duke përballuar vështirësi objektive e subjektive. Tradita duhet çuar më tej dhe në Institutin e Historisë besohet se instancat vendimarrëse do ta arsyetojnë e mbështesin materialisht idenë që studimet më të mira në vijim të publikohen periodikisht edhe në gjuhë të huaja.

